



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**Nr. Regj. 08-317**

**21.10 2022**

**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20, nenit 23 paragrafi 1 alineja 4 dhe nenit 85 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 2 nga Ligji për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuale („Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), e në pajtim me nenin 10 paragrafi 5 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i spastruar) nr.ark..01-3732/1 nga data 29.07.2019, Njoftimit për ndërprerjen e veprimtarisë nga ana e Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit - televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles (Up1 nr.08-317 nga data 05.10.2022), Plotësim – Njoftimi për ndërprerjen e veprimtarisë (Up1 nr.08-317 nga data 10.10.2022) dhe Konkluzionit me nr.ark..02-3850/2 nga data 21.10.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në mbledhjen e 40-të të mbajtur më datë 20.10.2022, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve**

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria tregtare e radiodifuzionit televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles.
2. Aktvendimi publikohet në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Shoqëria tregtare e radiodifuzionit (SHTR) televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles, është posedues i lejes për emetim nr.08-49 nga data 05.01.2015, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) viteve. (nga data 5 janar 2015 e deri më datë 4 janar 2024), për emetim përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel lokal për rajonin e Komunës së Velesit, Komunës së Çashkës, dhe Komunës Gradsko, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase.

Më datë 05.10.2022, SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles, në formë elektronike, në emailin zyrtar ([contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)) të Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi Njoftim për ndërprerje të veprimtarisë (Up1 nr.08-317), , në shtojcë të së cilës ishte dorëzuar edhe Deklarata për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për emetim televiziv me fuqi të ligjit, të lëshuar nga ana e Zoran Stavrev nga Velesi, në cilësinë e drejtuesit dhe si themelues/pronar i vetëm i radiodifuzerit, e vërtetuar në noter UZP nr.6279/2.022 nga data 05.10.2022., me të cilën deklarohet se SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles përfundimisht me datë 08.09.2022 ndërpret emetimin e programit televiziv. Gjatë kontrollit të deklaratës së lëshuar, nga ana e Agjencisë u konstatua se në të njëjtën duhet të bëhen korrigjime të caktuara.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles, në formë elektronike, në emailin zyrtar ([contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)) të Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

(Agjencia) dorëzoi Njoftim për ndërprerje të veprimtarisë (Up1 nr.08-317 nga data 10.10.2022), me shtojcë të deklaratës së re të korigjuar nga Zoran Stavrev nga Velesi, në cilësinë e drejtuesit dhe si themelues/pronar i vetëm i radiodifuzerit, e vërtetuar në noter UZP nr.6365/2022 nga data 10.10.2022., me të cilën deklarohet se SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles përfundimisht me datë 07.09.2022 ndërpret emetimin e programit televiziv. Radiodifuzeri në fjalë nuk ka borxhe ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85 paragrafi 1 alineja 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe Audiovizuale (LSHMAA), ndërpritet vlefshmëria e lejes për emetim televiziv me fuqi të ligjit me deklaratën me shkrim të pronarit, me të cilën e njofton Agjencinë se ndërpret emetimin e programit të radios ose televizionit. Për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për emetim të radios ose televizionit me fuqi të ligjit, Këshilli nuk sjell vendime. Agjencia do ta fshijë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerit nëse leja ka pushuar të vlejë me fuqi të ligjit (neni 85 paragrafi 2).

Në pajtim me të lartpërmendurën, në pajtim me neni 85 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 2 të LSHMAA si dhe Deklaratës së lartpërmendur të vërtetuar në noter UZP nr.6365/2022 nga data 10.10.2022, janë plotësuar edhe kushtet ligjore për fshirjen e radiodifuzerit SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20, neni 23 paragrafi 1 alineja 4 dhe neni 85 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 2 nga LSHMAA, Deklarata për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për emetim televiziv me fuqi të ligjit, të dhënë nga Zoran Stavrev nga Velesi, në cilësinë e drejtuesit dhe si themelues/pronar i vetëm i SHTR televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles, e vërtetuar në noter UZP nr.6365/2022 nga data 10.10.2022, në pajtim neni n10 paragrafi 5 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.ark..01-3732/1 nga data 29.07.2019 dhe Konkluzionit me nr.ark..02-3850/2 nga data 21.10.2022, u vendos si në dispozitivin.

**Agjencia për shërbime Mediatike  
audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit**

\_\_\_\_\_  
**Llazo PETRUSHEVSKI**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrative parashtrohet në 30 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit.

Dorëzuar deri te:

- Sektori për Përkrahje Informatike dhe Punë të Përgjithshme -Arkivi i Agjencisë;
- Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike;
- Sektori për Financa dhe Logjistikë
- Personat e caktuar në Agjenci, për udhëheqje të Regjistrimit Up1;
- Shoqëria tregtare e radiodifuzionit - televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles;
- Drejtuesi i Shoqërisë tregtare të radiodifuzionit televizioni KANAL-21 SHPKNJP Veles dhe
- Agjencia e Komunikimeve Elektronike e RMV-së.